



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:159134
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05758515

CAP.nr.1236/23

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Arsim Hamzaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit të përmbarimit A.Sh të cilit i është caktuar përfaqësuesja e përkohshme, bashkëshortja e tij H.Sh, kundër debitorit të përmbarimit F.Sh nga, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë PPP.nr.9/2023, të datës 18.05.2023, me datën **29.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit të përmbarimit F.Sh nga fshati ,, komuna e M,,, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë PPP.nr.9/2023, i datës 18.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Malishevë, me aktvendimin PPP.nr.9/2023, të datës 18.05.2023 e ka hedhur poshtë si të pa lejuar prapësimin i debitorit F.Sh nga fshati ,, komuna e M,,, i paraqitur kundër Urdhrit për zbrazjen dhe lirimimin e rrugës mbi paluajtshmërinë të Përmbaruesit Privat, me të cilin është caktuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorëve H.Sh, N.B, Z.J, D.G, B.SH, M.SH dhe B.SH të gjithë nga fshati ,, komuna e M,,, të cilët e pranojnë procedurën pas kreditorit të ndjerë A.SH, në bazë të dokumentit përmbarues: Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega Malishevë, C.nr.40/2015, i datës 02.02.2017, i plotfuqishëm prej datës 02.02.2017 dhe i ekzekutueshëm prej datës 22.12.2017.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore-përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me

propozim që gjykata e shkallës së dytë ta anuloj aktvendimin e goditur dhe ta kthej në rivendosje ose ta ndryshoj atë duke e refuzuar në tersi si të pa bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar i autorizuari i kreditorit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit të përmbartimit, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori A.Sh me datën 29.01.2018, ka paraqitur propozim për përmbartim, ndaj debitorit F.Sh nga fshati „, komuna e M„, në bazë të Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Malishevë C.Nr.40/2015 të datës 02.02.2017 ndërsa i plotfuqishëm prej datës 06.12.2017 dhe i ekzekutueshëm prej datës 22.12.2017. Përmbartuesi Y.K i emëruar në territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë me datën 29.01.2018, ka nxjerrë Urdhrin P.Nr.24/2018, me të cilin ka lejuar përmbartimin. Përmbartuesi Privat me datën 08.05.2019 ka nxjerr Urdhër P.Nr.24/2018 për Zbrazjen dhe Lirim të rrugës mbi palejueshmërinë e debitorit, ndaj këtij Urdhri Përmbartuesi Privat në Udhëzim Juridik kishte lejuar që pala e pakënaqur mund të ushtroj prapësim brenda afatit 7 ditësh, nga dita e pranimit të tij. Debitori ka paraqitur prapësim kundër Urdhërit P.Nr.24/18 të datës 08.05.2019.

Duke vendosur mbi prapësimin e debitorit, gjykata e shkallës së parë ka nxjerr aktvendimin e ankimuar PPP.Nr.9/2023, të datës 18.05.2019, me të cilën e ka hedhë poshtë si të palejuar prapësimin dhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas analizimit të shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit ndaj urdhrit për zbrazjen dhe lirim të rrugës mbi paluajtshmërinë të Përmbartuesit Privat, P.nr.24/2018, datë 08.05.2019, është i palejueshëm ngase Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin Ac.nr.2017/18 të datës 13.03.2019, e ka refuzuar ankesën e debitorit dhe ka vërtetuar aktvendimin PPP.nr.8/2018, të datës 28.03.2018, në rastin konkret Përmbartuesi Privat me rastin e nxjerrjes së Urdhërit për zbrazjen dhe lirim të rrugës mbi paluajtshmërinë nuk ka pasur të drejtë ta udhëzoj debitorin për të drejtën e paraqitjes së prapësimin për veprimet procedurale lidhur me përmbartimin e vendimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm. Kësisoj, në rastin konkret me shikim në shkresat e lëndës P.nr.9/2023, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se përmbartuesi privat Y.K, nuk është dashur ta udhëzoj debitorin për të drejtën e paraqitjes së prapësimin, me rastin e zbatimit të procedurës së përmbartimit në këtë çështje juridike të përmbartimit, ngase kemi të bëjmë me veprime procedurale dhe lidhur me këtë është në fuqi urdhri përmbartimor. Me dispozitën e nenit 284 pika 1 të LPP-së, te mënyra e zbatimit të përmbartimit është paraparë që: *“Procedura e përmbartimit me qëllim të zbrazjes dhe dorëzimit të sendit të paluajtshëm zbatohet ashtu që organi përmbartues, pasi t’i largojë personat dhe sendet nga paluajtshmëria, ia dorëzon atë në posedim kreditorit të përmbartimit.”* Par.2 i të njëjtit nen parasheh që: *“Zbrazja dhe dorëzimi i paluajtshmërisë bëhet vetëm pas kalimit të shtatë (7) ditëve nga dita në të cilën debitorit i është dorëzuar aktvendimi për përmbartimin ose urdhri*

përmbarues, i cili nuk ka paraqitur prapësim kundër aktvendimit ose urdhrit të këtillë. Në rast se kundër aktvendimit ose urdhrit për përmbarim debitori ka paraqitur prapësim, atëherë afati shtatë (7) ditor fillon të ecë nga dita në të cilën debitorit i dorëzohet aktvendimi për refuzimin e prapësimit.” Ndërsa në par. 4 parashihet se: “Fuqinë punëtore të nevojshme dhe mjetet për transport me qëllim të kryerjes së përmbarimit, ka për detyrë t’i sigurojë propozuesi i përmbarimit. Njoftimin lidhur me këtë, organi përmbarues duhet t’ia dërgoj kreditorit së paku shtatë (7) ditë para se të fillojë zbatimin e përmbarimit.”

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruar nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur prapësimin e debitorit e ka refuzuar si të pabazuar duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të ankimuar. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet e debitorit të përmbarimit *se gjykata e shkallës së parë nuk iu është përmbajtur aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac.Nr.4439/22 të datës 25.01.2023 e cila gjykatë sipas udhëzimeve është dashur që të gjitha të metat e paraqitura në aktvendimin e sipërcituar, shkeljet të evitohen dhe të vendoset në mënyrë meritore për çështjen.* Këto pretendime ankimore nuk u aprovuan për shkak se Gjykata e e Apelit e kishte konstatuar me vendimin Ac.4439/2022 të datës 25.01.2023 lidhur me këtë çështje përmbarimore, është nxjerrë Urdhri Përmbarimorë i cili është në fuqi, ndaj të cilit është ushtruar njëherë prapësim, është refuzuar prapësimi me Aktvendimin PPP.Nr.8/2018 të datës 28.03.2018, i cili aktvendim është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr. 2017/18 të datës 13.03.2019, tani më kanë mbetur vetëm veprime procedurale për zbatimin e përmbarimit. Përmbaruesi Privat me të drejtë ka nxjerr konkluzion P.nr.24/18 të datës 08.05.2019 për caktimin e përmbarimit dhe kundër këtij konkluzioni nuk është lejuar ushtrimi i mjetit juridik, sepse ndaj veprimeve procedurale nuk lejohet e drejta e paraqitjes së mjetit juridik, edhe përkundër faktit se përmbaruesi privat ka nxjerr urdhër për zbrazjen dhe lirimimin e paluajtshmërisë që ka qenë objekt shqyrtimi sipas aktvendimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm nuk është dashur që të lejohet e drejta e ushtrimit të mjetit juridik- prapësimit në afat prej 7 ditësh, sepse është veprim procedural dhe lidhur me këtë çështje është në fuqi Urdhri Përmbarimorë.

Tutje, nuk qëndrojnë as pretendimet e debitorit *se është dashur palët ndërgjyqëse të ftohen në një seancë në mënyrë që pretendimet dhe kundërshtimet e tyre ti dëgjojnë edhe gjykatësi, në mënyrë që në fund të nxjerr një vendim meritore,* për faktin se sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit me dispozitën e nenit 73 par. 1 është përcaktuar se “Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përyjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike

nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pes (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga Gjykata.”

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1236/23, me datën 29.05.2024

Gjyqtari
Arsim Hamzaj